



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:264589
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05574300

PA1.nr.105/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve V.R dhe B.R nga fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 , nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit B.R dhe mbrojtësit të të akuzuarit V.R, av. F.R, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1384/19 të dt.21.09.2022 , në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit B.R dhe ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit V.R, av. F.R, Anullohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1384/19 të dt.21.09.2022, dhe çështja i kthehet shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, P.nr.1384/19 të dt.21.09.2022, të akuzuarit V.R dhe F.R i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 , nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës dhe për të akuzuarin e parë V.R ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënim me të holla në shumën prej 200 (dyqind) euro, si dhe të akuzuarit të dytë B.R ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënim me të holla në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilat dënime të akuzuarit kanë për ti vuajtur brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e

plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe po ashtu të njëjtin afat janë të obliguar që ti paguajnë edhe dënimet e shqiptuara me gjobë. E në rast se të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenin 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtat dënim do t'u shndërrohen në dënim me burgim ashtu që për 20 (njëzet) euro gjobë të paguara i akuzuari do të vuaj 1 ditë burg. Obligohet i pandehuri që të paguaj për shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro gjobë do tu llogaritet 1 (një) ditë burgim. Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 30 (tridhjetë) euro, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. I dëmtuari H.R, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

I akuzuari, B.R për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së Ligjit Penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar dhe të akuzuarin B.R ta liroi nga akuza, apo, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, ashtu që ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.R, av, F.R, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj, në kuptim të nenit 398 par.1 nënpar. 1.3 lidhur me nenin 402 të KPP-së, ta ndryshojë në kuptim të nenit 398 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 403 të KPP-së.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.147/23 të datës 30.01.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit V.R av.F.R dhe ankesa e të akuzuarit B.R, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, ku prezantuan mbrojtësi i të akuzuarit V.R, av. F.R, i akuzuari, B.R, mbrojtësja e të akuzuarit B.R, av. SH.H-H dhe i dëmtuari, H.RR. Prokuroria e Apelit, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. I dëmtuari, H.RR deklaroi se i bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike. Mbrojtësi i të akuzuarit V.R, av. F.R deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës dhe propozimit si në ankesë duke shtuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, dhe se në rastin konkret nuk janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale, konsideron se gjykata nuk është mbështetur në prova të besueshme dhe konkretisht ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dëshmitë e dëshmitarit të dëmtuarit H.RR, dëshmitarët Y.D, D.B dhe A.R, po ashtu dëshmitarja Y.D ku të gjitha deklaratat e saj shihen kundërthënëse me njëra tjetrën. Si dëshmi kryesore e propozuar nga ana e Prokurorisë

Themelore në Ferizaj e që kjo dëshmi janë kamerat- incizimet, në të cilat incizime nuk është evidentuar fare se kush janë personat në të cilët shihen këto incizime, ku edhe konstatohet në seancën e datës 14.09.2022 se nuk ka mundur të bëhet evidentimi i personave të cilët gjinden në këtë incizim e të cilat janë incizime bardh e zi, andaj në rastin konkret konsideron se ka të bëjë me një përshkrim të aktakuzës, nuk ka as edhe një provë të qëndrueshme të drejtpërdrejt me të cilën do të provonte fajësinë e të mbrojturit të tij V.R, e që në rastin konkret prokuroria e shtetit me çdo kusht pretendon vetëm me prova rrethore jo të drejtpërdrejta, duke marrë parasysh këtë fakt edhe shkresat e lëndës në drejtësi parim kryesor është prezumimi i fajësisë dhe ngritja e aktakuzës me prova të drejtpërdrejta duke marr parasysh nenin 19 par 1 nën par 1.12 të KPPK-së duke propozuar që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza në mungesë të provave. Mbrojtësja e të akuzuarit, B.R deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së të akuzuarit dhe propozimit si në ankesë, duke shtuar se i bashkëngjitet dhe përkrah fjalët e kolegut av. F.R dhe shton se me asnjë provë nuk është vërtetuar se veprën e ka kryer i mbrojturi i saj dhe se asnjëherë nuk ka pasur një urdhëresë dhe përderisa nuk ka një urdhëresë nga gjykata, gjykata është dashur këto prova ti shpall si prova të papranueshme sepse nuk mundet ta mbështes aktgjykimin në prova të papranueshme përderisa gjyqtari nuk ka lëshuar urdhëresë për marrjen e video incizimeve. Ka shtuar se në video incizime nuk mund të identifikohen siç ka thënë edhe pala e dëmtuar, ndërsa lidhur me deklaratën e dëshmitares Y.D se nëse është e vërtet si e ka përshkruar në deklaratën e saj se ka shkuar me veturë me të dyshuarit, ka qëndru në veturë përderisa dyshohet se kanë dalur të pandehurit dhe kanë kryer veprën penale, atëherë përderisa ka shkuar me ta, ka qëndru me ta, e ka pa që kanë marrë cigare, kanë marrë të holla atëherë përse nuk u përfshi edhe ajo në procedurë, është dashur të përfshihet e jo të trajtohet si dëshmitare në rastin konkret si dhe ka shumë shkelje të tjera të cilat janë të elaboruara në ankesë. Kërkon nga kolegjti që ta vlerësoj në mënyrën më të mirë të mundshme sepse i mbrojturi i saj tani ka krijuar marrëdhënie pune në ndërtimtari, ka disa gjasa që do të martohet dhe të krijoj familje, andaj ti ketë këto rrethana parasysh. I akuzuari, B.R deklaroi se qëndron pranë ankesës së parashtruar brenda afatit ligjor dhe propozim si në ankesë dhe përkrah fjalën e avokates së tij mbrojtëse.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesat janë të bazuara.

I akuzuari B.R, e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë , për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së Ligjit Penal, ku pretendon se aktgjykimi është i kundërligjshëm. Tutje shton se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 380 par.1 nënpar,1.12 të KPRK-së, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës me arsyetimin e aktgjykimit dhe në veçanti me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Konsideron se dispozitivi i këtij aktgjykimi nuk përcakton elementin kyç të veprës penale të vjedhjes, e që është malli apo pasuria e luajtshme e përvetësuar. Aktgjykimi nuk përcakton se cila paska qenë shumta e të hollave të metalta të vjedhura , cila paska qenë sasia e cigareve të vjedhura, lloji i cigareve të vjedhura, respektivisht cila qenka saktë lartësia e dëmit i cili i qenka shkaktuar të

dëmtuarit H.RR. Aq më tepër , i dëmtuari H.RR as vet në deklarinimet e tij nuk e ka potencuar asnjëherë të vetme as sasinë e cigareve të vjedhura , as llojin e tyre dhe as shumën e të hollave të metalta. Pretendon se gjykata nuk mund ta shpall fajtor dikend për vjedhje pa e përcaktuar lartësinë e dëmit të shkaktuar, pa e përshkruar llojin dhe vlerën e saktë të pasurisë së paluajtshme e cila pretendohet se është vjedhur. Po ashtu shton se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 384, par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së lidhur me nenin 370 par.7 të KPRK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur qartë se cilat fakte janë të provuara dhe cilat janë të paprovuara, e po ashtu , nuk ka vlerësuar dhe paraqitur në mënyrë të drejtë dhe të kuptueshme e të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara si dhe saktësinë e provave kundërthënëse. Në këtë çështje penale , as gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë. Kjo për faktin se nga aktgjykimi i atakuar rezulton se ngjarja, respektivisht vjedhja ka ndodhur me datën 27.10.2018, ndërkaq që i dëmtuari H.RR e ka paraqitur rastin po të njëjtën ditë dhe po ashtu i ka dorëzuar kamerat e lokalit, ndërkaq që ,të akuzuarit janë intervistuar nga ana e policisë pas një viti. Si është e mundur kjo? Tutje , shton se nëse të akuzuarit janë identifikuar nga ana e kamerave, e në të cilat kamera aktgjykimi mbështetet si prova që vërtetojnë kinse të akuzuarit janë fajtorë, atëherë , përse u nevojit mbi një vit , pra tek në vitin 2019, që të akuzuarit të identifikohen dhe të ftohen për intervistim nga ana e policisë?! Aq më tepër kur , kamerat e minimarketit, sikurse deklarohet edhe vet i dëmtuari H.RR, nuk kanë mundur fare të shihen fytyrat e personave të cilët janë futur në minimarket. Nga një arsyetim i tillë i gjykatës, arrihet në përfundim se të akuzuarit janë shpallur fajtor jo me prova bindëse dhe të pakontestueshme, por , vetëm sipas dyshimit dhe indicieve të paraqitura nga ana e zyrtarëve policorë. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të dispozitave tjera të cilat esencialisht kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar , si dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike respektivisht vlerësimi i gabuar i fakteve dhe provave , ka pasur për pasojë shkeljen e Ligjit Penal në dëm të akuzuarit B.R ngase nuk është provuar me asnjë provë materiale relevante e asnjë fakt çoftë i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj me vet faktin e ngritjes së aktakuzës dhe nxjerrja e aktgjykimit të ankimuar është shkelur në mënyrë flagrante Ligji Penal, ngase B.R është akuzuar për veprën të cilën nuk e ka kryer, respektivisht është aplikuar gabimisht dispozita ligjore e nenit 34 të KPK-së. Propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar dhe të akuzuarin B.R ta liroi nga akuza , apo, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, ashtu që ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit, V.R, av. F.R e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me pretendimet se Gjykata Themelore në Ferizaj ka bërë shkelje të Kodit të procedurës konkretisht nenit 331. Edhe pse nuk mund të mirren në pyetje dëshmitarët nga ana e gjykatës, gjykata i ka marrë në pyetje. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit nuk i ka marr fare për bazë rrethanat lehtësuese edhe pse i ka potencuar në aktgjykimin me të ciklën është shpallur fajtor i akuzuari, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk është recidivist. I akuzuari deri më tani nuk ka qenë i dënuar për asnjë vepër penale dhe se është hera e parë që ballafaqohet

me një vepër penale, i njëjti ka pasur sjellje korrekte si ndaj gjykatës edhe ndaj të dëmtuarit. Tutje pretendon se gjykata fare nuk e ka marrur parasysh faktin se tani të pandehurit punojnë e që edhe në seancat e kaluara gjyqësore është kërkuar nga ana e organit të akuzës ta vërtetoj faktin se a janë në kamera-inçizime i mbrojturi i tij V.R , këtë fakt nuk është konstatuar, e që në rastin konkret forezika e mjekësisë ligjore në vendin e ngjarjes mund ta verifikonte nëpërmjet vijave papilare të gishtërinjëve . Arsyet të cilat e përjashtojnë nga përgjegjësia penale V.R janë se me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka elemente të veprës penale sepse nuk është vërtetuar se ka kryer vepër penale për të cilën ngarkohet në aktakuzë, propozon që çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje .Andaj , vlerëson se gjykata e shkallës së parë arsyet në bazë të dyshimit si dhe kushtet tjera ligjore , i ka vlerësuar të njëanshme , respektivisht i ka vlerësuar arsyet të cilat janë potencuar nga dëshmitarja dhe nuk ka marrë parasysh pretendimet e të pandehurit , rrethana këto të cilat gjykata nuk i ka vlerësuar. Propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj , në kuptim të nenit 398 par.1 nënpar. 1.3 lidhur me nenin 402 të KPP-së , ta ndryshojë në kuptim të nenit 398 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 403 të KPP-së.

Me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi edhe sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 pika 2.7 lidhur me nenin 369 par. 7 dhe 10 të KPPRK-së e që lidhen edhe me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga neni 386 par. 3 të KPPK-së dhe shkeljes së ligjit penal sepse në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, gjithashtu, në mënyrë të veçantë nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, shkelje këto të karakterit absolut e të cilat detyrimisht kushtëzojnë anulimin e këtij aktgjykimi, posaçërisht sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të kësaj gjykate nuk ka arritur të jap sqarime të drejta të ligjshme dhe të plota në mes të veprimeve të të akuzuarve dhe lidhjes eventuale kauzale me veprën penale për të cilën janë akuzuar, shkelje këto të karakterit absolut që detyrimisht kushtëzuan anulimin e këtij aktgjykimi.

Po ashtu sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka arrit që ta vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Provat si personale po ashtu edhe ato materiale drejtë i ka administruar porse të njëjtat sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të kësaj gjykate të njëjtat nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, përkatësisht provat materiale nuk i ka vlerësuar fare, të njëjtat nuk i ka krahasuar njëra me tjetrën edhe arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim është i mangët. Të gjitha këto paraqesin sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të kësaj gjykate shkelje të karakterit absolut e të cilat detyrimisht kushtëzojnë anulimin e këtij aktgjykimi, shkelje këto që lidhen edhe me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Kolegji penal i gjykatës së apelit konstatoi se arsyetimi i aktgjykimit ka kundërthënënie të konsiderueshme për faktet vendimtare ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim lidhur me përmbajtjen e shkresave të lëndës ose të procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë. Aktgjykimin e gjykatës së shkallës

së parë e bëjnë kontradiktor dhe të pa qëndrueshëm fakti se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vlerësimin e secilës provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë por vetëm mjaftohet me listimin e këtyre provave në aktgjykimin e ankimuar. Po ashtu aktgjykimin e ankimuar e bëjnë kontradiktor edhe konstatimet e gjykatës së shkallës së parë rreth vlerësimit të mbrojtjes së të akuzuarve për faktin se në aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë në njërin anë nuk ua fali besimin mbrojtjes së të akuzuarve duke konstatuar se mbrojtja e tillë është orientuar në fshehjen e veprimeve inkriminuese të akuzuarve dhe në zvogëlimin e përgjegjësisë së tyre penale ndërsa nga ana tjetër aktgjykimin e ankimuar e bazon pjesërisht në mbrojtjen e të akuzuarve duke konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar pjesërisht edhe nga deklaratimet e të akuzuarve gjatë marrjes në pyetje të tyre në shqyrtimin gjyqësorë. Po ashtu edhe vlerësimin i CD nuk është i plotë pasi që në aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë provë është përshkruar ngjarja e cila shihet në incizim ku përshkruhen veprimet e dy personave, ku në fund përshkruhet se “meqenëse kamerat kanë bërë incizimet bardh e zi nuk mund të vërehet ngjyrat e veshjeve të personave të lartëcekur që kanë hyrë në lokal” pra nuk ceket apo nuk është vërtetuar se kush ishin këta persona, a ishin të akuzuarit këta persona, apo kush ishin. Kolegji penal i gjykatës së apelit konstatoi se edhe përkundër faktit se këto prova nuk janë përshkruar dhe elaboruar në aktgjykimin e ankimuar duke konstatuar se i falet besimi këtyre provave, gjykata e shkallës së parë nxjerr përfundim se është provuar fakti se të akuzuarit ka kryer veprën penale sipas përshkrimit të aktakuzës, e që aktgjykimin e ankimuar e bëjnë kontradiktor dhe të pa qëndrueshëm.

Pra sipas Gjykatës së Apelit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar në mënyrë të duhur aktgjykimin e ankimuar me këtë rast edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e që të gjitha këto aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë e bëjnë të paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim duhet edhe njëherë të administroi të gjitha provat si ato personale dhe materiale, të dëgjoi dëshmitarët si dhe provat e tjera në lëndë, të bëjë përshkrimin, analizimin dhe vlerësimin e secilës provë, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 2 të KPPRK-së të bëjë vlerësimin e secilës provë një nga një dhe në lidhje me të gjitha provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 402 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.105/23, më datë 27.02.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Mehmet Ndrecaj

Zyhdi Haziri
